

“Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë të bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë”

QA



European Commission
TEMPUS



Çfarë është sigurimi i cilësisë?

Sigurimi i cilësisë është element esencial për të krijuar një hapësirë evropiane të arsimit të lartë, të krahasueshme dhe atraktive, të bazuar në objektivat e Procesit të Bolonjës. Sigurimi i cilësisë nënkupton krijimin e mundësive të transformimit të studentëve, duke shtuar në vazhdimësi vlerën e njohurive të tyre dhe zhvillimit personal. Kështu, arsimi i ofruar përmes qëllimit në përputhje me standardet e pranuar publikisht të përgjegjësisë, të integritetit dhe të transparencës. Prandaj, sigurimi i cilësisë është një funksion jetik në arsimin e lartë bashkëkohor dhe duhet të përfshijë të gjithë pjesëmarrësit.

Cilësia kërkon krijimin e sistemit për sigurim të cilësisë, kërkon krijimin e modeleve të vlerësimit si dhe promovimin e kulturës së cilësisë nëpër institucione. Mechanizmat rregullues për sigurimin e cilësisë, që promovojnë qasje dhe që krijojnë kushte për kompletimin e studimeve nga mësimnxënësit, duhet integruar në tërë sektorin e sistemit të arsimit të lartë.

Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë

Procesi i Bolonjës i ka vënë theks të veçantë rëndësisë së përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Kështu, studentët, gjithnjë e më shumë janë duke u përfshirë në përmirësimin e cilësisë së eksperiencave të tyre të mësimnxënies. Përfshirja e tyre bëhet nëpërmjet dhënies së vlerësimit në fund të lëndëve që ata kanë zgjedhur, kontributit në zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndët përkatëse, pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes në bartës të arsimit të lartë, ose përfaqësimit të këndvështrimeve të studentëve në mënyra të ndryshme, për shembull: përmes unioneve të studentëve ose trupave të tjerë përfaqësues. Në ditët e sotme, zëri i studentëve dëgjohet më shpesh dhe ata japin opinionet për çështje të ndryshme të institucionit arsimor, prandaj këndvështrimet e tyre duhet marrë parasysh. Pjesëmarrja e studentëve në zhvillimin e politikave dhe të aspekteve të ndryshme të institucionit arsimor në përgjithësi, është një anë shumë e rëndësishme në edukimin e plotësishëm të qytetarëve dhe të specialistëve të fushave të ndryshme.





Pjesëmarrja e menaxhmentit dhe e stafit administrativ në procesin e sigurimit të cilësisë

Menaxhimi dhe koordinimi efektiv janë praktika esenciale në funksionimin e shëndoshë të bartësit të arsimit të lartë. Stafi menaxhues i bartësve të arsimit të lartë, stafi administrativ dhe mësimdhënësit punojnë së bashku me studentët në hulumtim dhe në arritje të misionit që t'i sigurojnë përparësi krahasuese institucionit arsimor. Në këtë mënyrë do të demonstrojnë vizion të menduar strategjik dhe konsideratë për praktikën më të mira në administrimin e arsimit të lartë. Si i tillë, menaxhmenti do të sigurojë procedura të suksesshme për sigurimin e cilësisë përmes efikasitetit të vazhdueshëm, përmes motivimit të udhëheqësve të departamenteve dhe përmes balancimit e kombinimit nga qasja lart-poshtë.

Për të arritur këtë, duhet siguruar resurse humane, fonde dhe infrastrukturë për zbatimin e nismave dhe të aktiviteteve për sigurim të cilësisë, në mënyrë që në këto procese të përfshihet i tërë stafi akademik dhe joakademik.

Varet nga secili institucion i arsimit të lartë përcaktimi se cilat instrumente ose procedura duhet aplikuar, pastaj cilat procese të sigurimit të cilësisë dëshirojnë t'i imple-

mentojnë në nivele të ndryshme organizative dhe po ashtu të përcaktojnë nivelin e shkathtësive të brendshme në lidhje me këto procese.

Përfshirja e mësimdhënësve në procesin e sigurimit të cilësisë

Mësimdhënësit janë në qendër të shumë nismave të cilësisë së mësimdhënies. Pjesa më e madhe e suksesit, e realizuar nga mbështetja e siguruar për të rritur cilësinë, varet nga pranimi i mësimdhënësit dhe nga përdorimi i instrumenteve që janë në dispozicion të tyre gjatë ushtrimit të aktivitetit të mësimdhënies.

Iniciativa e cilësisë së mësimin përfaqëson një mundësi për mësimdhënësit që të mendojnë dhe të reflektojnë për veprimet e tyre dhe për rolin e tyre në rritjen e cilësisë. Për të arritur suksesin e iniciativave të tilla, është e rëndësishme që pranimi dhe angazhimi të reflektojë praktikë dhe adaptim të vazhdueshëm, në mënyrë që të arrihet inovacioni. Është e rëndësishme të lidhen praktikat, metodat dhe mjetet, me politikën institucionale të cilësisë së mësimdhënies dhe të ndërliken pritjet e mësimdhënësve me programin, ose pritjet e institucionit në aspektin e rezultateve të mësimnxënies. Në hartimin dhe në zbatimin e kurrikuleve, bashkëpunimi me njësitë e sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë përfaqëson një fillim të mbarë.





Linqe dhe literaturë relevante

Linqe

European Association for Quality Assurance in Higher Education: <http://www.enqa.eu/>

European University Association: <http://www.eua.be/Home.aspx>

Bologna Process: http://ec.europa.eu/education/higher-education/doc1290_en.htm

Publikime

„Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area“; ENQA, 3rd edition, 2009:

http://www.enqa.eu/pubs_esg.lasso

This project has been funded with support from the European Commission. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

